



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:202072
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05729326

P. nr.148/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, së bashku me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me Nd.nr.11/2024, të datës 01.03.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1455/2022, të datës 30.09.2022, kundër të akuzuarit N. (Z.) M. nga fshati G., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par. 1. nën par. 1.3 të KPP-së, dhe nenit 2 par. 2, 8, 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), **më 22 maj 2024, nxjerri këtë:**

A K T V E N D I M

I. MIRATOHET marrëveshja me numër Nd.nr.11/2024, të datës 01.03.2024 e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Malishevë, ndërmjet të akuzuarit N. (Z.) M. nga fshati G., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par. 6 të KPRK-së dhe të dëmtuarës KEDS- Distrikti në Gjakovë, me përfaqësues Arjana Mula, në anën tjetër.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1455/2022, të datës 30.09.2022.

III. PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit N. (Z.) M. nga fshati G., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, për shkak se i pandehuri dhe e dëmtuara, kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr.1455/2022, të datës 30.09.2022, N. (Z.) M. nga fshati G., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Gjykata më 21.02.2024, e ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë e duke vepruar ne bazë të nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Institutin për Ndërmjetësim në Malishevë.

Më 01.03.2024, në Qendrën për Ndërmjetësim në Malishevë, është arritur marrëveshja Nd.nr.11/2024, në mes të palëve në procedurë. Andaj gjykata duke vepruar në bazë të dispozitës së nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovojë këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin më datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data **22 maj 2024**, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u morën në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par. 1. nën par. 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2,15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.148/2022, më 22 maj 2024**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.